



Instituti i Kërkimeve Urbane

FLETË INFORMUESE MBI PROJEKTET

Instituti i Kërkimeve Urbane

Zbatimi i Projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Konteksti i projektit

GIZ po zbaton projektin "Shërbimet Komunale të Qëndrueshme (Menaxhimi i Mbetjeve) 2014-2017". Qëllimi i programit fokusohet në mbështetjen e komunave të përzgjedhura në Kosovë në pëputhje me mandatin e tyre ligjor të nënshkruar në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Ligji i amenduar i mbetjeve (2012) përfaqëson bazën ligjore për aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve në Kosovë. Sipas këtij ligji është detyrë e komunave për të plotësuar planet vendore mbi menaxhimin e mbetjeve (Artikulli 15, par.1.8). Qëllimi i kësaj detyre konsulente është të ndihmojë komunat dhe programin GIZ-SMS të hartoj dhe planifikojë zbatimin e mundëshëm dhe konkret të projekteve pilot të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në katër qytete, duke përfshirë Prishtinën, Gjilanin, Mitrovicën, dhe komunën e Drenasit.

Qëllimi i projektit

Në kuadër të këtij projekti, IKU do të ndërtojë një sistem të integruar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në disa komuna, parashikuar të kalojë në disa faza (në terma afatmesëm-afatgjatë) për të mbulur të gjithë territorin e Kosovës në pëputhje me Planin lokal/kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve si dhe në pëputhje me synimet e riciklimit sipas EU (2020/2025). Përpjekjet pilote do të kombinojnë zbatimin e përqasjeve të ndryshme si dhe të mundësojnë bazat për të shtrirë më tej ndarjen në burim si dhe sistemin e mbledhjes së diferencuar në komunat e Kosovës.

Nga ana tjetër përpjekjet pilote do të shërbejnë si bazë mësimore për të mësuar mbi planifikimin dhe zbatimin e përqasjeve



të njëjta në komunat e përfshira në projekt të cilat mbulojnë të gjithë territorin e Kosovës.

Metodologjia dhe përqasja

Metodologjia e mëposhtme e propozuar nga IKU bazohet në "Qëllimin e Punës".

➤ Analizimi i projekteve pilote nga vizitat në terren, diskutimet e grupeve të punës të SHKQ, si dhe rishikimet e dokumenteve dhe analizat e situatës. Për të realizuar këtë komponent IKU do të marr në konsideratë:

- Sistemin e mbledhjes së mbetjeve
- Opinionet e qytetarëve
- Analizën e grupeve të interesit.

➤ Zhvillimin e planeve teknike dhe financiare të bazuara në konceptin e projektit të rënë dakord në bashkëpunim me të gjithë grupet e interesit të përfshirë.

FAKTET KRYESORE

DONATORËT:

- ✓ GIZ

KOHËZGJATJA:

Maj 2015-Shtator 2015

PËRFITUESIT:

- ✓ Qyteti i Prishtinës
- ✓ Qyteti i Drenasit
- ✓ Qyteti i Mitrovicës
- ✓ Qyteti i Gjilanit
- ✓ Banorët e këtyre qyteteve
- ✓ Komunat e këtyre qyteteve

KONTAKT:

Edlir Vokopola
Koordinator Projekti

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.

Aktivitetet e projektit

- Analizimi i projekteve pilote nga vizitat në terren, diskutimet e grupeve të punës të SHKQ, si dhe rishikimet e dokumenteve dhe analizat e situatës.
- 1. Ndërtimi i një platform për mbledhjen dhe/ose rishikimin e të dhënave cilësore dhe sasiore.
- 2. Hartimi i një plani veprimi për bashkëpunimin dhe punën e përbashkët ndërmjet Konsulentit, grupit të punës GIZ-SHKQ si dhe grupeve të punës së komunave.
- 3. Vizita në çdo komunë, duke përfshirë edhe vizitat në terren; takime me autoritetet për të konfirmuar angazhimin në zbatimin e projektit si dhe takime me grupet e punës për të ndarë mendime, për të konsoliduar njohuritë dhe realizimi i një plani të përbashkët veprimi për të zhvilluar një analizë të gjëndjes aktuale.

4. Organizimi i takimeve fokus grup me çdo grupinteresi me rëndësi në çdo komunë.
 5. Mbledhja dhe rishikimi i të dhënave dhe informacioneve.
 6. Realizimi i analizave së sitatës, duke përfshirë projektimin e të dhënave të detajuara sasiore
 7. Zhvillimi i një seminari dhe ofrimi i asistencës mbi llogaritjen e kostove dhe tarifave si dhe zërave të tjera sipas kërkesave të komunave pjesmarrëse.
 8. Hartimi dhe rënia dakort mbi sistemin për ndarjen e mbetjeve në burim si dhe mbledhjen e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme.
 9. Konsolidimi dhe kërkesa miratimi/marrëveshje të konceptit të projektit nga GIZ-SHKQ dhe grupet e punës së komunave.
- Zhvillimin e planeve teknike dhe financiare të bazuara në koncept projektin e rënë dakord në bashkëpunim me të gjithë grupet e

interesit të përfshirë.

1. Përcaktimi i objektivave dhe treguesve
2. Përcaktimi i aktiviteteve dhe mjeteve të lidhura me zbatimin e tyre
3. Vlerësimi i kostove të aktiviteteve dhe sasisë së mjeteve
4. Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi për grupet e interesit
5. Përcaktimi i kohëzgjatjes së aktiviteteve
6. Përcaktimi aktual dhe projektimi i treguesve për matjen e performancës dhe zhvillimi i sistemit benchmarking.
7. Miratimi i planeve të veprimit.



Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.